

AKTI THEMELUES I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR SH.P.K "BEAN"

Neni 1

Ne baze te ligjit Nr. 7638, dt. 19.11.1992, "Per Shoqerite Tregtare" , une i quajtura :

Arben Gjojdeshi, i biri i Sabriut dhe i Merushes, i datelindjes 26.3. 1966, lindur e banues ne Fier, me zotesi te plote juridike per te vepruar , shpall formimin e shoqerise private me pergjegjesi te kufizuar (SH.P.K), te quajtur "BEAN".

Neni 2

Shoqeria si person juridik zhvillon veprimtarine e saj ne te gjitha territorin e Republikes se Shqiperise, ne perputhje me legjisllacionin ne fuqi , statutin dhe kete akt themelimi.

OBJEKTI I SHOQERISE

Neni 3

Objekti i shoqerise eshte:

Ndertimi i objekteve te te gjitha llojeve e per te gjitha sferat (industriale, bujqesore, turistike, hidroteknike, banesa, ndertim rruges, prodhime te materialeve te ndertimit si inerte, gure, zhavorr, cakull, gelqere dhe parafabrikate te te gjitha llojeve, instalimet elektrike e hidraulike, tregtim te mallrave industriale e ushqimore me shumice e pakice, importi dhe eksporti, tregtim karburantesh te llojeve te bdryshme, transport mallrash e pasagjeresh brenda dhe jashte vendit.

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 4

Kapitali fillestar i shoqerise eshte 100 000 leke me para dhe i depozituar ne Banken e Shtetit. Ky kapital eshte vene vetem nga Ortaku i vetem themelues Arben Gjojdeshi.

SELIA E SHOQERISE

Neni 5

Selia e shoqerise eshte ne kete adrese:

Arben Gjojdeshi, lagja "Apollonia", rruga Mehmet Kallashi, Nr 24, Fier.

Shoqeria mund te hape edhe vendqendrim te tjera, operative dhe filiale ne territorin e Republikes se Shqiperise.

AFATI I VEPRIMTARISE

Neni 6

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj mbi dhjete vjet te njepasnjeshme e larte. Aktiviteti i saj mund te zgjase me shume se dhjete vjete, por edhe mund te





nderpritet ne cdo kohe me vendim te ortakut themelues, sipas rasteve te parashikuara ne statut.

Neni 7

Shoqeria mban pergjegjesi per te gjitha detyrimet fiskale dhe sigurimet shoqerore.

Neni 8

Fitimi i realizuar nga shoqeria eshte kopetence ekskluzive e ortakut te vetem , i cili vendos per perdorimin e tij dhe per krijimin e fondit rezerve.

Neni 9

Shoqeria fiton zotesine per te vepruar me regjistrimin e saj ne regjistrin tregetar ne Gjykaten e Rrethit Tirane.

Neni 10

Shoqeria fillon aktivitetin e saj ne momentin e regjistrimit ne organin kopetent shteteror per marrjen e licenses (dega Tatimeve Fier)

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 11

Menyra dhe drejtimi i shoqerise jane te percaktuara ne statutin e shoqerise. Administratori i shoqerise caktohet z. Arben Gjojdeshi (ortaku i vetem).

Neni 12

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen ne baze te legkislacionit te punes, me kontrata individuale dhe kolektive midis shoqerise dhe punemarresve.

Neni 13

Shoqeria ka vulen e saj ne te cilen shkruhet:
SH.P.K "BEAN" Fier

VLEFSHMERIA E AKTIT THEMELUES

Neni 14

Ky akt themelues eshte lidhur per nje periudhe jo me pak se dhjete vjet, por ky afat mund te ndryshoje sipas vendimit qe do te marre ortakut i vetem themelues i shoqerise.

ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE

Neni 15

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin ne veprimtarine e shoqerisedo te zgjidhen nga gjykata ne rast se nuk do te zgjidhen me mirekuptim dhe konsensus.

Neni 16



Ceshtjet qe nuk jane rregulluar ne kete akt themelimi rregullohen ne statutin e shoqerise qe ii bashkengjitet si pjese perberese e saj.

Neni 17

Ne qofte se shoqeria do te pushoje veprimtarine e saj , atehere do te caktohet nje komision likuidimi , i cili do te paraqese bilancin e likuidimit.

Neni 18

Ky akt themelimi hyn ne fuqi daten e nxjerrjes dhe te nenshkrimt nga Ortaku i vetem themelues.

ORTAKU I VETEM THEMELUES
Arben GJOJDESHI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA FIER
Nr 620 Rregj

Fier, me 9/02 1998

VERTETIM

Vertetohet se sot me date 9/02 1998, para meje Noterit Minella Milo, u paraqit z. Arben Gjojdeshi, i biri i Sabriut dhe i Merushes, i dt. 1966, lindur e banues ne Fier, me zotesi te plote juridike per te vepruar dhe nenshkroi Aktin e Themelimit te mesiperm ne prezencen time.

NOTERI
Minella Milo



STATUT
I SHOQERISE PRIVATE ME PERGJEGJESI TE
KUFIZUAR
SH.P.K. "BEAN"

Ne mbeshtetje te ligjit Nr. 7638, dt. 19.11.1992, "Per shoqerite Tregetare", une i quajhuri Arben Gjojdeshi, i biri i Sabriut dhe i Merushes, dt. 1966, lindur e banues ne lagjen "Apollonia", Fier, me zotesi te plote juridike per te vepruar, shpall formimin e Shoqerise private me pergjegjesi te kufizuar (SH.P.K.), te quajtur "BEAN", me Statutin si me poshte:

FORMIMI I SHOQERISE "BEAN"

Neni 1

Formohet shoqeria private e quajtur "BEAN", shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (SH.P.K.), nga z. Arben Gjojdeshi (Ortaku i vetem), qe perballon humbjet deri ne kufirin e vleres se kapitalit themeltar.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Neni 2

Objekti i shoqerise eshte:

Ne fushen e ndertimit te objekteve te te gjitha llojeve e per te gjitha sferat (industriale, bujqesore, turistike, hidroteknike, banesa, ndertim ruges, proshime te materialeve te ndertimit si inerte, gure, zhavorr, cakull, gelqere dhe parafabrikate te te gjitha llojeve, instalimet elektrike e hidraulike, tregetimi te mallrave industriale e ushqimore me shumoce e pakice, importi dhe eksporti, tregetim karburantesh te llojeve te ndryshme, transport mallrash e pasagjeresh brenda e jashte vendit.

KOHE ZGJATJA E SHOQERISE

Neni 3

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarin e saj mbi dhjete vjet te njepasnjeshme e larte.

Neni 4

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin e saj , seline dhe objektin e saj, sipas vendimit qe do te marre Ortaku i vetem i shoqerise.

SELIA E SHOQERISE

Neni 5

Selia e shoqerise eshte ne kete adrese:

Arben Gjojdeshi, Lagja "Apollonia", Rruga "Mehmet Kallashi", Nr. 24, Fier.

Shoqeria mund te hape edhe vend qendrim te tjera operative dhe filiale ne territorin e Republikes se Shqiperise.

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 6





Kapitali fillestar i shoqerise eshte 100 000 leke.
Ky kapital eshte vene vetem nga Ortaku themelues Arben Gjojdeshi.
Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet ne te gjitha menytrat e lejuara nga ligji, ne baze te vendimit qe do te marre Ortaku i vetem i shoqerise.

Neni 7

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, gjithashtu pjeset e kapitalit themeltar mund te transferohen edhe te treteve, persone ose shoqerive me miratimin e ortakeve.

Gjithashtu ato jane te transferueshme ne rast ndarje pasurore midis bashkeshorteve si dhe ne rruge trashegimie.

Transferimi i pjaseve te kapitalit themeltar duhet te behen me nje akt noterial.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 8

Shoqeria drejtohet dhe administrohet nga nje ose me shume drejtues (Administratore), persona fizike, pjesemarres ose jo ne shoqeri, me ose pa kufizim mandati te tyre te zgjedhur nga ortaku themelues.

Neni 9

Ortaku i vetem si dhe Administratori i kesaj shoqerie eshte Arben Gjojdeshi. Ai sipas nevojave qe paraqiten per zhvillimin e veprimtarise se shoqerise emerit administrator, keshillin drejtues, si dhe puneson specialiste dhe punetore te aktiviteteve te ndryshme.

Neni 10

Ortaku i vetem percakton drejtimet kryesore te veprimtarise se shoqerise, si dhe drejton, organizon e kontrollon kete veprimtari, miraton planin ekonomik-financiar, bilancet, deklaratat e ndryshme si dhe merr masa per plotesimin e kerkesave te parashikuara ne dispozitat ligjore ne fuqi.

Neni 11

Ortaku i vetem miraton Rregulloren e brendeshme te aktivitetit te shoqerise, strukturen organizative, lidh kontrata me te tretet dhe vendos per zgjidhjen e tyre ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Neni 12

Ortaku i vetem vendos per marrjen e kredive dhe perdorimin e tyre.

Neni 13





Ortaku i vetem lidh kontrata individuale dhe kolektive, sipas rastit per realizimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me legjislacionin e punes dhe statutin , te cilet jane te detyrueshem per t'u zbatuar.

Neni 14

Perfaqesimi i shoqerise i perket Ortakut te vetem, si dhe administratoreve ne rastet e autorizuar.

Ata kane te drejte te perfaqesojne shoqerine ne organet gjyqesore dhe ne organet e ndryshme shteterore vete ose nepermjet avokateve te caktuar prej tyre.

Neni 15

Mosmarreveshjet qe mund te lindin midis shoqerise dhe te punesuarve zgjidhen nga Gjykata ne rast se nuk zgjidhen me mirekuptim.

Neni 16

Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme ne te cilen shkruhet:
SH.P.K. "BEAN" Fier.

Neni 17

Emertimi i shoqerise, kapitali themeltar dhe emrat e Ortakeve duhet te jene te permendura ne te gjitha aktet dhe dokumentat e nxjerra nga kjo shoqeri qe i'u drejtohet te treteve.

SEKRETI I PUNES

Neni 18

Konsiderohen si sekrete pune te kesaj shoqerie te gjitha aktet dhe dokumentet qe jane vendosur nga Ortaku i vetem i shoqerise.

KONTROLLI I BRENDSTEM


Neni 19

Shoqeria organizon kontroll te brendshem me ekspert kontabel te autorizuar dhe te emeruar me afat te caktuar ose te percaktuar ne baze te kerkesave ligjore.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

Neni 20

Shoqeria nderton veprimtarine e saj ekonomike-financiare mbi bazen e leverdise ne kushtet e ekonomise se tregut te lire, mbeshtetur ne kapitalin baze, ne fondin themeltar e mjetet e xhiros, mundesite e kreditimit dhe te huazimit nga shteti apo



persona te tjere fizike e juridike, brenda e jashte vendit ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, me mundesite e investimeve.

Veprimtaria ekonomike kryhet ne vazhdimesi dhe gjen pasqyrimin e saj ne bilancin periodik.

Neni 21

Shoqeria ka llogarine e saj rrjedhese ne Banken e Shtetit Shqiptar dhe mund te hap edhe ne vende te tjera nepermjet te cilave kryen veprimtarine e saj bankare.

Neni 22

Ne bilancin periodik , pasurite e saj jane te shprehura ne monedha shqiptare dhe sipas rastit edhe ne monedhe te huaj ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Ne baze te ketij legjislacioni shoqeria percakton edhe format e bilanceve e te llogarive per dokumentimin e veprimtarise ekonomoko-financiare.

Neni 23

Bilanci mbyllet me 31 Dhjetor te cdo viti.

Llogarite vjetore , inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga ekspertet kontabel, miratohen ne mbledhjen e asamblese brenda nje afati kater mujor nga data e mbylljes se vitit financiar.

Neni 24

Shoqeria kur e shikon te perligjur mund te investoje ne nd/je, shoqeri e persone te tjere fizike e juridike, vendas e te huaj, kapitalet e saj.

Neni 25

Ne shoqeri mund te aderojne edhe persona te tjere ne kushtet e percaktuara nga ortaku themelues.

Neni 26

Personat aderues kane po ato te drejta dhe detyrime si dhe ortaku themelues , me perjashtim te atyre kufizimeve qe jane vendosur me rastin e aderimit te tyre ne shoqeri.

Neni 27

Me rastin e largimit te personave aderues , ata mbartin me vete pjesen e fitimit qe u takon deri ne momentin e largimit te tyre, si dhe detyrimet e shoqerise po per kete periudhe.

Neni 28





Perdorimi i fitimit eshte kopetence eskluzive e ortakut te vetem , i cili vendos per perdorimin e tij dhe per krijimin e fondit rezerve.

Neni 30

Shoqeria deklarohet e krijuar daten e regjistrimit ne Regjistrin Tregetar ne Gjykatën e Rrethit Tirane.

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ekonomike me regjistrimin si subjekt privat ne organin tatimor perkates ne Rrethin Fier.

SHPERNDARIA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

Neni 31

Shoqeria pushon veprimtarine e saj ne keto raste:

- Ne rastet e parashikuara ne ligj.
- Ne rast ndarje, bashkimi me persona te tjere juridike e fizike.
- Ne rast pamundesie per te vazhduar veprimtarine per te cilen eshte krijuar
- Me urdher te organit kopetent sgteteror si rrjedhoje e shkeljes se ligjit
- Kur perfundon qellimin per te cilin eshte krijuar

Ne keto kushte shoqeria krijon Komisionin e likuidimit i cili paraqet bilancin e likuidimit.

Mbas mbylljes se shoqerise, ajo kryen te gjitha veprimet dokumenare te nevojshme per cregjistrimin nga regjistri tregetar.

Neni 32

Ky statut hyn ne fuqi ditën e nenshkrimimit nga Ortaku i vetem i shoqerise.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE
SH.P.K. "BEAN"
Arben GJOJDESHI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA FIER
Nr 619 Rregj.

Fier, me 9/02/ 1998

VERTETIM

Vertetohet se sot me dt. 9/02/ 1998, para meje noterit Minella Milo, u paraqit Z. Arben Gjojdeshi, i biri i Sabriut dhe i Merushes, dt. 1966, lindur e banues ne Fier, me zotesi te plote juridike per te vepruar i identifikuar sipas ligjit dhe nenshkroi statutin e mesiperme ne prezencen time.

NOTERI

Minella MILO

